

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Valon Totaj – kryetar i kolegjit dhe Rustem Thaçi e Burim Shala - anëtar të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditëses S.M. nga fshati ... komuna e Lipjanit, të cilën me autorizim e përfaqëson av.RR.R. nga Lipjani, kundër të paditurës Komuna e Lipjanit – Drejtoria për Arsim, të cilën me autorizim e përfaqëson F.M., për shkak të kompensimit të të ardhurave personale, duke vendosur sipas ankesës së të paditurës, të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë – Dega në Lipjan C.nr.456/2013, të datës 10.03.2014, në seancën e kolegjit të mbajtur me datën 27.07.2018, mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e të paditurës Komuna e Lipjanit – Drejtoria për Arsim, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë – Dega në Lipjan C.nr.456/2013, të datës 10.03.2014, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë, me aktgjykimin e ankimuar C.nr.456/2013, të datës 10.03.2014, e ka aprovuar kërkesëpadinë e paditëses S.M. nga fshati ... Komuna e Lipjanit, si të bazuar dhe e ka obliguar të paditurën Komuna e Lipjanit – Drejtoria për Arsim, që paditëses t'ia paguaj shumën prej 480.41 €, në emër të pagave të pa paguara, për punët dhe detyrat e punës si mësimdhënëse e Gjuhës Shqipe SH.F.M.U. "Ibrahim Banushi", në fshatin ..., për periodën prej 15.01.2012, e deri me 29.02.2012, me kamatë vjetore prej 3.5 %, siç e paguajnë bankat për mjete të deponuara pa destinim të caktuar mbi një vit, duke filluar prej datës 10.12.2013, e deri tek pagesa definitive, si dhe shumën prej 269.20 €, në emër të shpenzimeve të procedurës kontestimore, të gjitha këto në afat prej 7 dite nga dorëzimi i aktgjykimit, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.

Kundër këtij aktgjykimi e paditura në afat ligjor ka paraqitur ankesë duke e atakuar aktgjykimin e goditur për shkak të shkeljes të dispozitave të procedurës materiale, vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike dhe për shkak të shkeljeve esenciale të procedurës kontestimore, me propozim që gjykata e shkallës së dytë ta aprovojë ankesën e të paditurës Komuna e Lipjanit si të bazuar dhe ta prishë aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë – Dega Lipjan C.nr.456/2013, me datë 10.03.2014 dhe lënda t'i kthehet në rigjykim dhe vendosje gjyaktës së shkallës së parë.

Paditësja nuk ka paraqitur përgjigje në ankesë.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të dispozitës së nenit 194 dhe 195 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

Ankesa e të paditurës, është **e pabazuar**.

Nga shkresat e lëndës rezulton se me datë 10.12.2013, paditësja në gjykatën e shkallës së parë ka paraqitur padi kundër të paditurës për shkak kompensimit të të ardhurave personale me arsye sikurse në padi. E paditura me datë 06.02.2014, ka parashtruar përgjigje në padi me të cilën e ka kontestuar kërkesëpadinë e paditëse si të pabazuar duke theksuar se paditësja i ka përmbushë obligimet sipas kontratës së punës, por nuk iu kanë paguar pagat sipas kontratës së punës në shumë prej 480.41 € për periodën 15.01.2012 deri me 29.02.2012, për shkak të rrethanave buxhetore komunale.

Gjykata e shkallës së parë duke vepruar sipas padisë së paditëses, pas shqyrtimit dhe administrimit të provave të paraqitura nga palët ndërgjyqëse si dhe vlerësimin e të gjitha shkresave të lëndëve ka nxjerrë aktgjykimin e atakuar C.nr.456/2013, të datës 10.03.2014, me të cilin e ka e ka aprovuar kërkesëpadinë e paditëses S.M., duke vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar. Në arsyetim të aktgjykimit ka theksuar se nuk është kontestuese fakti se paditësja tek e paditura ka themeluar marrëdhënie pune në kohë të caktuar prej 4 muaj e 15 ditë dhe të njëjtës e paditura i ka mbetur borxh për t'ia paguar pagat prej një muaj e 15 ditë pune. Gjithashtu nuk është kontestuese fakti se paditësja i ka përmbushë obligimet e veta kontraktuese. Andaj gjykata duke u mbështetur në dispozitat e nenit 55 paragrafi 1 të Ligjit të Punës nr.03/L-212, të shpallur me datë 01.11.2010, nenit 277 të LMD-së dhe nenit 3 të Ligjit mbi ndryshimin dhe plotësimin e ligjit mbi Marrëdhëniet Detyrimore ka vendosur sikurse në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar. Vendimet mbi shpenzimet e procedurës gjykata e ka nxjerrë duke u bazuar në nenin 452 paragrafi 1 dhe 2 të LPK-së.

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson së qëndrimi dhe përfundimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika (b), (g), (j), (k) dhe (m) e LPK-së, dhe se e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë, për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK-së.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore për shkeljet që i referohen gjendjes faktike pasi që gjykata e shkallës së parë në procedurën e të provuarit ka administruar provat e paraqitura nga palët ndërgjyqësore me të cilat ka vërtetuar gjendjen faktike të përshkruar si në arsyetim të aktgjykimit. Në arsyetim të aktgjykimit gjykata e shkallës së parë i është përmbajtur dispozitës së nenit 160 paragrafi 4 i LPK-së, në atë mënyrë që ka përshkruar kërkesat e palëve, faktet që kanë parashtruar palët, provat e propozuara dhe të administruara, si dhe mënyrën se si janë vlerësuar provat e administruara.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, qëndrimi dhe përfundimi juridik i gjykatës së shkallës së parë për themelësinë e kërkesëpadisë është i drejtë dhe i bazuar, pasi që me dispozitën e nenit 130 paragrafi 1 të LMD-së përcaktohet se "*Kontrata krijon të drejta dhe*

detyrime për palët kontraktuese.”, ndërsa me dispozitën e nenit 245 paragrafi 1 parashihet se “*Kreditori në marrëdhënien e detyrimit ka të drejtë që prej debitorit të kërkojë përmbushjen e detyrimit, ndërsa debitori ka për detyrë ta përmbushë atë me ndërgjegje dhe në tërësi, në përputhje me përmbajtjen e tij.*”. Në kuptim të këtyre dispozitave rezulton se gjykata e shkallës së parë me të drejtë e ka gjetur si të themeltë bazueshmërinë e kërkesëpadiisë. Ndër të tjera edhe vetë e paditura përgjatë procedurës pranë gjykatës së shkallës së parë, e ka pohuar fakin se për shkak të mungesës së mjeteve financiare nuk kanë qenë në gjendje që këtu paditëses t’ia paguajnë detyrimin e mbetur.

Nga arsyet e cekura Gjykata e Apelit, gjeti së gjykata e shkallës së parë në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme ka vendosur në këtë çështje juridike, prandaj në mbështetje të dispozitave nga neni 194 dhe 195 paragrafi 1 pika (d) e lidhur me nenin 200 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
Ac.nr.1621/14, me datën 27.07.2018

Kryetari i kolegjit - Gjyqtari
Valon Totaj